

No. 50278*

**France
and
Albania**

Agreement between the Government of the French Republic and the Council of Ministers of the Republic of Albania on exchange and mutual protection of classified information. Tirana, 3 May 2011

Entry into force: *1 December 2012, in accordance with article 15*

Authentic texts: *Albanian and French*

Registration with the Secretariat of the United Nations: *France, 1 December 2012*

*No UNTS volume number has yet been determined for this record. The Text(s) reproduced below, if attached, are the authentic texts of the agreement /action attachment as submitted for registration and publication to the Secretariat. For ease of reference they were sequentially paginated. Translations, if attached, are not final and are provided for information only.

**France
et
Albanie**

Accord entre le Gouvernement de la République française et le Conseil des ministres de la République d'Albanie relatif à l'échange et à la protection réciproque d'informations classifiées. Tirana, 3 mai 2011

Entrée en vigueur : *1er décembre 2012, conformément à l'article 15*

Textes authentiques : *albanais et français*

Enregistrement auprès du Secrétariat des Nations Unies : *France, 1er décembre 2012*

* Numéro de volume RTNU n'a pas encore été établie pour ce dossier. Les textes reproduits ci-dessous, s'ils sont disponibles, sont les textes authentiques de l'accord/pièce jointe d'action tel que soumises pour l'enregistrement et publication au Secrétariat. Pour référence, ils ont été présentés sous forme de la pagination consécutive. Les traductions, s'ils sont inclus, ne sont pas en form finale et sont fournies uniquement à titre d'information.

Qeveria e Republikës Franceze,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,

Këtu të quajtura “Palët”,

Me dëshirën për të siguruar mbrojtjen e informacionit dhe materialeve të klasifikuara të shkëmbyera ose të prodhuara ndërmjet dy Shteteve ose ndërmjet institucioneve publike ose private, të cilat i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të tyre kombëtare përkatëse,

Kanë rënë dakord për përcaktimet e mëposhtme.

NENI 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

- 1.1 **"Informacion i Klasifikuar"** është informacioni, dokumentet dhe materialet, pavarësisht nga forma, natyra ose mënyra e transmetimit të tyre, të përgatitura ose që përgatiten, për të cilat është caktuar një shkallë klasifikimi ose nivel sensitiviteti dhe që, në interes të sigurisë kombëtare dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të Palëve, kërkon mbrojtjen ndaj çdo shkeljeje, shkatërrimi, përvetësimi, përhapjeje, humbjeje ose aksesit nga ndonjë individ i paautorizuar ose një lloj tjetër kompromentimi.
- 1.2 **"Autoritet i Sigurisë Kombëtare" (ASK)** është autoriteti i brendshëm, përgjegjës për kontrollin e përgjithshëm dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për secilën prej Palëve.
- 1.3 **"Autoritete Kompetente të Sigurisë" (AKS)** është çdo Autoritet i Emëruar për Sigurinë (AES) ose çdo autoritet tjetër kompetent i autorizuar në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të Palëve që është përgjegjës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje sipas fushave përkatëse.
- 1.4 **"Kontratë e Klasifikuar"** është një kontratë, një nën-kontratë ose projekt, përgatitja ose zbatimi i të cilit kërkon akses në Informacionin e Klasifikuar ose përdorimin dhe prodhimin e Informacionit të Klasifikuar.
- 1.5 **"Palë Kontraktuese"** është çdo individ ose subjekt juridik që ka zotësinë ligjore për të nënshkruar dhe lidhur Kontrata të Klasifikuara.

- 1.6 "Pala e Origjinës", është Pala, duke përfshirë çdo institucion publik ose privat i cili i nënshtrohet ligjeve dhe rregullave të saj kombëtare, që lëshon ose jep Informacion të Klasifikuar për Palën tjetër.
- 1.7 "Pala Marrëse" është Pala, duke përfshirë çdo institucion publik ose privat i cili i nënshtrohet ligjeve dhe rregullave të saj kombëtare, të cilit/të cilës i transmetohet Informacion i Klasifikuar.
- 1.8 "Palë e Tretë" është çdo Shtet, duke përfshirë subjektet juridike ose individët nën juridiksionin e tij ose organizatë ndërkombëtare që nuk është palë në këtë Marrëveshje.
- 1.9 "Pala Pritëse" është Pala në territorin e së cilës zhvillohet një vizitë.
- 1.10 "Nevojë për njohje" është nevoja për të pasur akses në Informacionin e Klasifikuar në 'kuadrin' e një pozicioni të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre specifike.

NENI 2

Fusha e zbatimit

Kjo Marrëveshje përcakton rregullat e përgjithshme të sigurisë që zbatohen për çdo shkëmbim të Informacionit të Klasifikuar ndërmjet Palëve ose ndërmjet institucioneve të tyre publike ose private të cilat i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të tyre kombëtare.

NENI 3

Autoritetet e Sigurisë Kombëtare

Autoriteti i Sigurisë Kombëtare për secilën Palë është:

Për Republikën e Shqipërisë:

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)
Këshilli i Ministrave
Bul. "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë

Për Republikën Franceze:

Secrétariat général de la défense et de la sécurité nationale (S.G.D.S.N.)
51, bd de La Tour-Maubourg
75700 PARIS 07 SP

Palët informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim në lidhje me Autoritetin e tyre të Sigurisë Kombëtare si dhe Autoritetet e tyre Kompetente të Sigurisë.

NENI 4

Parimet e Sigurisë

- 4.1 Në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare përkatëse, Palët marrin masat përkatëse për të mbrojtur Informacionin e Klasifikuar të transmetuar, marrë ose krijuar në bazë të përcaktimeve të kësaj Marrëveshjeje dhe i jep atij informacioni një nivel mbrojtjeje të barasvlershëm me atë që j është dhënë Informacionit të Klasifikuar të vet të brendshëm, sipas përcaktimit në Nenin 5, paragrafi 5.1.
- 4.2 Pala Marrëse i vendos Informacionit të Klasifikuar të marrë nga Pala e Origjinës klasifikimin e vet të brendshëm, në pajtim me barasvlershmërinë përcaktuar në Nenin 5, paragrafi 5.1.
- 4.3 Aksesit në Informacionin e Klasifikuar u rezervohet rigorozisht qytetareve të Palëve që janë pajisur me certifikatë të përshtatshme dhe detyrat e të cilëve e kanë të rëndësishme aksesin në atë informacion mbi bazën e Nevojës për Njohje.
- 4.4 Pala Marrëse nuk e ul nivelin apo deklasifikon Informacionin e Klasifikuar të transmetuar pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së Origjinës.
- 4.5 Palët informojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo ndryshim që ndikon në mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, të shkëmbyer ose të prodhuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje.
- 4.6 Informacioni i Klasifikuar i transmetuar nuk mund të përdoret për qëllime ndryshme nga ato për të cilat është transmetuar.
- 4.7 Palët sigurojnë që të respektohet çdo kërkesë që lind nga ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare të sigurisë në lidhje me sigurinë e agjencive, zyrave dhe strukturave nën juridiksionin e tyre, në veçanti nëpërmjet inspektimeve.

NENI 5

Klasifikimet dhe Barasvlefshmëria e sigurisë

- 5.1 Palët marrin përsipër të mbrojnë Informacionin e Klasifikuar të shkëmbyer dhe miratojnë barasvlershmërinë e niveleve të klasifikimit të sigurisë të përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

SHQIPËRI	FRANCE
TEPËR SEKRET	TRES SECRET DEFENSE
SEKRET	SECRET DEFENSE
KONFIDENCIAL	CONFIDENTIEL DEFENSE
IKUFIZUAR	(shih paragrafët 5.2 dhe 5.3 më poshtë)

- 5.2 Republika Franceze përpunon dhe mbron informacionin e shënuar "I KUFIZUAR" të transmetuar nga Republika e Shqipërisë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj kombëtare në fuqi në lidhje me informacionin e mbrojtur por të paklasifikuar, si "DIFFUSION RESTREINTE".
- 5.3 Republika e Shqipërisë përpunon dhe mbron informacionin e paklasifikuar por të shënuar si të mbrojtur, si "DIFFUSION RESTREINTE" të transmetuar nga Republika Franceze në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj kombëtare në fuqi në lidhje me mbrojtjen e informacionit "IKUFIZUAR".
- 5.4 ASK-të ose AKS-të informojnë njëra-tjetrën për çdo klasifikim të ri sigurie ose ndryshim klasifikimi lidhur me informacionin që mund të shkëmbehet ose prodhohet në bazë të kësaj Marrëveshjeje.
- 5.5 Për shkaqe të sigurisë specifike, nëse Pala e Origjinës kërkon që aksesin në Informacionin e Klasifikuar të kufizohet për personat që kanë ekskluzivisht shtetësinë e Palëve, ky informacion do të mbajë shënimin shtesë "SPECIAL FRANCE – ALBANIA".
- 5.6 Me qëllim që të ruhen standardet e barasvlershme të sigurisë, me kërkesë të njëres prej Palëve, secila Palë jep të gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat kombëtare të sigurisë që zbatohen për të siguruar sigurinë e Informacionit të Klasifikuar. Secila Palë bie dakord të lehtësojë kontaktet ndërmjet ASK-ve dhe AKS-ve të tyre përkatëse.

NENI 6

Procedura e certifikimit të sigurisë

- 6.1 Për akses në informacionin e klasifikuar KONFIDENCIAL / CONFIDENTIEL DEFENSE ose në një nivel më të lartë, secila Palë zbaton një procedurë të certifikimit të sigurisë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj kombëtare.
- 6.2 Për çertifikatën e sigurisë së një qytetari të një prej Palëve që ka qëndruar ose që vazhdon të jetë në territorin e Palës tjetër, ASK-ja ose AKS-ja e secilës prej Palëve ndihmojnë njëra-tjetrën në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj kombëtare.

- 6.3 Palët njohin reciprokisht çertifikatat e sigurisë të lëshuara për qytetarët e tyre në kuadër të aksesit në Informacionin e Klasifikuar.
- 6.4 Nëse ASK-ja ose AKS-ja e një prej Palëve është e mendimit që një shoqëri e regjistruar në territorin e saj kombëtar është në pronësi ose kontrollohet nga një Shtet i tretë, qëllimet e të cilit nuk janë në pajtueshmëri me interesat e saj, asaj shoqërie nuk i lëshohet çertifikatë sigurie. Për rrjedhojë, ASK-të ose AKS-të e Palëve që kanë kërkuar çertifikatë sigurie për një strukturë njoftohen sa më shpejt të jetë e mundur.
- 6.5 ASK-të ose AKS-të njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet që ndikojnë mbi çertifikatat e sigurisë të qytetarëve të tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht, në rastin e tërheqjes së çertifikatës ose uljes së nivelit të saj.

NENI 7

Përdorimi i Informacionit të Klasifikuar

- 7.1 Pala Marrëse nuk mund të përhapë Informacionin e Klasifikuar të shkëmbyer ose përgatitur sipas kësaj Marrëveshjeje një Palë të tretë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të ASK-së ose AKS-ve të Palës së Origjinës.
- 7.2 Informacioni i Klasifikuar i përgatitur së bashku nga Palët sipas marrëveshjeve, kontratave ose në kuadër të një aktiviteti të përbashkët nuk mund të ulet në nivel sigurie, deklasifikohet ose t'i dërgohet një Palë të Tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.
- 7.3 Para transmetimit të një Informacioni të Klasifikuar të marrë nga Pala e Origjinës tek Palët Kontraktuese, ASK-ja ose AKS-të e Palës Marrëse duhet:
- a) të sigurojnë që Palët Kontraktuese dhe strukturat e tyre janë në gjendje të japin mbrojtje të përshtatshme për Informacionin e Klasifikuar,
 - b) të japin nivelin e përshtatshëm të çertifikimit për strukturat e Palëve përkatëse Kontraktuese;
 - c) të japin nivelin e përshtatshëm të çertifikatës për individët në pajtim me parimin "Nevojë për njohje";
 - d) të sigurojnë që të gjithë individët që kanë akses në Informacionin e Klasifikuar janë instruktuar në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre që rrjedhin nga ligjet dhe rregulloret e zbatueshme të kombëtare.
 - e) të kryejnë kontrollat e sigurisë të strukturave përkatëse.

NENI 8

Përkthimi, Riprodhimi dhe Shkatërrimi

- 8.1 Pala Marrëse i shënon riprodhimet dhe përkthimet e bëra si origjinalet dhe u jep atyre të njëjtën mbrojtje.
- 8.2 Informacioni i klasifikuar TEPËR SEKRET / TRES SECRET DEFENSE as nuk riprodhohet as nuk përkthehet. Dokumente origjinale dhe përkthime shtesë mund të jepen pas kërkesës me shkrim drejtuar Palës së Origjinës.
- 8.3 Informacioni i klasifikuar TEPËR SEKRET / TRES SECRET DEFENSE nuk duhet të shkatërrohet, përveç kur shkatërrimi është i autorizuar shprehimisht nga Pala e Origjinës. Ai i kthehet Palës së Origjinës në pajtim me paragrafët 9.1 ose 9.2 më poshtë, pasi të jetë njohur më tej i panevojshëm ose me skadimin e vlefshmërisë së tij.
- 8.4 Përkthimi dhe riprodhimi i informacionit të klasifikuar SEKRET / SECRET DEFENSE autorizohet vetëm me pëlqimin me shkrim të ASK-së ose AKS-ve së Palës së Origjinës.
- 8.5 Informacioni i Klasifikuar shkatërrohet në mënyrë të tillë që të jetë e pamundur për ta rindërtuar atë plotësisht ose pjesërisht.
- 8.6 Në situata krizash kur bëhet e pamundur të mbrohet dhe kthehet Informacioni i Klasifikuar i gjeneruar ose i dhënë në pajtim me këtë Marrëveshje, Informacioni i Klasifikuar shkatërrohet menjëherë. ASK-ja e Palës Marrëse njofton ASK-në e Palës së Origjinës në lidhje me shkatërrimin e Informacionit të Klasifikuar sa më shpejt të jetë e mundur.

NENI 9

Transmetimi i Informacionit ndërmjet Palëve

- 9.1 Informacioni i klasifikuar dërgohet nga njëra Palë tek tjetra nëpërmjet kanaleve diplomatike në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të Palës së Origjinës.
- 9.2 ASK-të ose AKS-të, me marrëveshje të përbashkët, mund të bien dakord që Informacioni i Klasifikuar mund të dërgohet me mjete të ndryshme nga ato të kanaleve diplomatike nëse kjo metodë transmetimi duket e papërshtatshme ose e vështirë.
- 9.3 Transmetimi duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- a) Korrieri ka certifikatë të përshtatshme sigurie. Korrieri është një punonjës i përhershëm i shoqërisë dërguese ose marrëse ose i përket administratës dhe ka një certifikatë sigurie të paktën të nivelit të Informacionit të Klasifikuar që transmetohet;
 - b) Korrieri ka një certifikatë korrieri të dhënë nga ASK-ja ose AKS-ja e dërguesit ose marrësit;
 - c) Pala e Origjinës mban një regjistrë të Informacionit të Klasifikuar të transmetuar dhe një ekstrakt nga regjistri i jepet Palës Marrëse me kërkesë;
 - d) Informacioni i Klasifikuar paketohet dhe vuloset në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të Palës së Origjinës;
 - e) Marrja e Informacionit të Klasifikuar konfirmohet me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur.
- 9.4 Transmetimi i një sasive të konsiderueshme Informacioni të Klasifikuar organizohet ndërmjet ASK-ve dhe AKS-ve rast pas rasti.
- 9.5 Informacioni i Klasifikuar transmetohet elektronikisht në formë të kriptuar, duke përdorur metodat dhe mjetet kriptografike të pranuar bashkërisht nga ASK-të ose AKS-të përkatëse.

NENI 10

Kontratat e Klasifikuara

- 10.1 ASK-ja ose AKS-të e Palës së Origjinës njoftojnë ASK-në ose AKS-të e Palës Marrëse për çdo Kontratë të Klasifikuar para shkëmbimit të Informacionit të Klasifikuar. Ky njoftim mund të specifikojë nivelin më të lartë të klasifikimit të informacionit të përfshirë në Kontratë.
- 10.2 Pala që ka ndër mend të lidhë ose të autorizojë një prej Palëve të saj Kontraktuese të lidhë një Kontratë të Klasifikuar me një Palë Kontraktuese të Palës tjetër kontrollon nëpërmjet ASK-së ose AKS-ve të kësaj Pale që kjo Palë Kontraktuese ka nivelin e përshtatshëm të certifikatës për të përmbushur Kontratën. Në mungesë të një certifikate të tillë, ASK-ja ose AKS-të e Palës Marrëse fillojnë një procedurë certifikimi në nivelin e përshtatshëm.
- 10.3 Para lidhjes së një Kontrate të Klasifikuar me një Palë Kontraktuese e cila ndodhet në juridiksionin e Palës tjetër, apo autorizimit të një prej Palëve të veta Kontraktuese për të lidhur një Kontratë të Klasifikuar në territorin e Palës tjetër, një Pale i jepet së pari garanci me shkrim nga AKS-ja ose ASK-të të Palës tjetër që, Palës Kontraktuese të propozuar i është dhënë një nivel certifikate të përshtatshme dhe që ajo ka marrë të gjitha masat e përshtatshme të sigurisë që kërkohen për të mbrojtur Informacionin e Klasifikuar.
- 10.4 Për një Kontratë të Klasifikuar, hartohet një shtojcë sigurie. Në këtë shtojcë, ASK-ja ose AKS-të e Palës së Origjinës specifikojnë se çfarë duhet të mbrohet nga Pala Marrëse si dhe nivelin përkatës të zbatueshëm të klasifikimit. Vetëm Pala e Origjinës mund të modifikojë nivelin e klasifikimit të informacionit të përcaktuar në shtojcën e sigurisë.

- 10.5 Të gjitha Kontratat e Klasifikuara përmbajnë informacion në lidhje me udhëzimet e sigurisë si dhe një udhëzim klasifikimi. Këto udhëzime janë në pajtim me ato të dhëna nga ASK-ja ose AKS-të e Palës së Origjinës.
- 10.6 ASK-ja ose AKS-të e Palës së Origjinës i dërgojnë një kopje të shtojcës së sigurisë AKS-së ose ASK-ve të Palës tjetër.
- 10.7 ASK-ja ose AKS-të e Palëve në territorin e të cilave duhet të kryhet puna duhet të sigurojnë, në kuadrin e përmbushjes së Kontratave të Klasifikuara, që të zbatohet dhe ruhet një nivel sigurie, të barasvlershëm me atë të kërkuar për të mbrojtur Kontratat e tyre të Klasifikuara.
- 10.8 Para nënshkrimit të një Kontrate të Klasifikuar me një palë nën-kontraktuese, Pala Kontraktuese autorizohet nga ASK-ja ose AKS-të e veta. Palët nën-kontraktuese respektojnë të njëjtat kushte sigurie si ato të hartuara për Palën Kontraktuese.

NENI 11

Vizitat

- 11.1 Vizitat në ambientet e një prej Palëve ku një perfaqësues i Palës tjetër ka akses në Informacionin e Klasifikuar ose në vendet ku aksesin në këtë Informacion është drejtpërdrejt i mundur i nënshtrohet autorizimit paraprak me shkrim nga ASK-ja ose AKS-të e Palës pritëse.
- 11.2 Vizitat tek ambientet e një Pale nga një Palë e Tretë që mundësojnë akses në Informacionin e Klasifikuar të shkëmbyer ose të prodhuar ndërmjet Palëve ose në vendet ku aksesin në këtë Informacion është drejtpërdrejt i mundur i nënshtrohet autorizimit paraprak me shkrim nga ASK-ja ose AKS-të e Palës tjetër.
- 11.3 Vizitat e përmendura në paragrafin 11.1 dhe 11.2 më sipër kërkojnë që të gjithë vizitorët të kenë çertifikatë të përshtatshme sigurie dhe Nevojë për njohje.
- 11.4 Kërkesat për vizita kur kërkohet akses për Informacionin e Klasifikuar të nivelit **TEPËR SEKRET / TRES SECRET DEFENSE** dërgohen nëpërmjet kanaleve diplomatike tek ASK-ja e Palës Pritëse. Kërkesat për vizita kur kërkohet aksesin në Informacionin e Klasifikuar i një niveli më të ulët përpunohen drejtpërdrejt ndërmjet ASK-ve ose AKS-ve përkatëse. Kërkesat dërgohen të paktën tre (3) javë para datës së kërkuar për vizitën.
- 11.5 Kërkesa për vizitë duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
 - a) Emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë dhe numrin e pasaportës ose të kartës së identitetit;
 - b) Punën dhe pozicionin e vizitorit, emrin e strukturës ose institucionit që ka punësuar atë;
 - c) Nivelin e çertifikatës së sigurisë së vizitorit, të vërtetuar nga një çertifikatë sigurie që jepet nga ASK-ja ose AKS-ja e Palës kërkuuese;

- d) Datën e propozuar të vizitës dhe kohëzgjatja e planifikuar;
 - e) Qëllimin e vizitës dhe të gjithë informacionin e nevojshëm që specifikon subjektet që do të trajtohen të cilat prekin Informacion të Klasifikuar dhe nivelet e tij të sigurisë;
 - f) Emrat e strukturave, ambienteve dhe veñdeve që preken nga vizita;
 - g) Mbiemrat dhe emrat e individëve që duhet të presin vizitorin;
 - h) Datën, nënshkrimin dhe vulën zyrtare të ASK-së ose AKS-ve të Palës kërkuese.
- 11.6 Secila Palë mund të kërkojë një autorizim për një vizitë për një periudhë maksimale prej dymbëdhjetë (12) muaj. Nëse një vizitë e caktuar nuk mund të bëhet brenda afatit kohor të parashikuar në autorizim për një vizitë ose nëse kërkohet një shtyrje e periudhës së parashikuar në autorizim për një vizitë, Pala kërkuese mund të kërkojë një autorizim të ri për një vizitë, parashikuar që ajo të bëhet të paktën tre (3) javë para skadimit të autorizimit të tanishëm.
- 11.7 Të gjithë vizitorët respektojnë rregulloret e sigurisë dhe udhëzimet e Palës Pritëse.
- 11.8 Palët mund të përpilojnë një listë të personelit të autorizuar për të kryer disa vizita në lidhje me një projekt, program ose kontratë specifike në pajtim me modalitete standarde të rena dakord nga ASK-ja ose AKS-të e Palëve. Nëse, këto lista janë të vlefshme për një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh dhe me marrëveshje ndërmjet ASK-së ose AKS-ve të Palëve, kjo periudhë vlefshmërie mund të shtyhet për periudha të tjera që nuk kalojnë në total dymbëdhjetë (12) muaj.
- 11.9 Listat e përmendura në paragrafin 11.8 të mësipërm hartohen në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të Palës Pritëse. Sapo këto lista të jenë aprovuar, modalitetet standarde të çdo vizite specifike mund të përpilohen drejtpërdrejt nga strukturat që do të vizitohen personat e përmendur në këto lista.

NENI 12

Shkeljet e Sigurisë

- 12.1 Në rastin e një shkeljeje të rregulloreve kombëtare në lidhje me mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar të transmetuar sipas kësaj Marrëveshjeje, ose në rastet kur, nuk mund të përjashtohet, prezumohet ose zbulohet, veçanërisht në rastin e humbjes ose të një lloji tjetër komprometimi të pandershëm të dyshuar ose të provuar, ASK-ja ose AKS-të e Palës tjetër njoftohen menjëherë me shkrim.
- 12.2 Njoftimi duhet të përmbajë detaje të mjaftueshme në mënyrë që Pala e Originës të mund të vlerësojë plotësisht pasojat.
- 12.3 Pala që ka zbuluar ose dyshuar faktet kryen menjëherë një hetim (me ndihmën e Palës tjetër, nëse është e nevojshme), në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme kombëtare të Shtetit përkatës. Pala që kryen hetimin informon ASK-në ose AKS-të e Palës tjetër për konstatimet e hetimit, masat e vendosura dhe veprimet korrigjuese të marra sa më shpejt të jetë e mundur.

NENI 13

Shpenzimet

- 13.1 Në parim, përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nuk gjeneron ndonjë kosto të veçantë.
- 13.2 Të gjitha shpenzimet e shkaktuara nga një Palë për llogari të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje mbulohen vetëm nga kjo Palë.

NENI 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 14.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet ekskluzivisht me konsultime ndërmjet palëve, pa thirrur asnjë Palë të tretë apo gjykatë ndërkombëtare.
- 14.2 Gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes, Palët marrin përsipër të respektojnë detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje.

NENI 15

Dispozita të fundit

- 15.1 Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar. Secila prej Palëve njofton Palën tjetër për përfundimin e procedurave të brendshme në lidhje me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ajo hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas marrjes së njoftimit të fundit.
- 15.2 ASK-ja ose AKS-të e Palëve zhvillojnë konsultime për aspekte specifike teknike në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe mund të përfundojnë çdo instrument të përshtatshëm ligjor ose protokoll të veçantë sigurie për të plotësuar këtë Marrëveshje rast pas rasti.
- 15.3 Secila Palë njofton menjëherë Palën tjetër për çdo ndryshim në ligjet dhe rregulloret e veta kombëtare që mund të kenë efekt mbi mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar sipas kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast, Palët zhvillojnë konsultime me qëllim që të shqyrtojnë çdo ndryshim të mundshëm në këtë Marrëveshje. Ndërkohë, Informacioni i Klasifikuar vazhdon të mbrohet në pajtim me këto dispozita.

- 15.4 Dispozitat e kësaj Marrëveshje mund të ndryshohen me marrëveshje të përbashkët me shkrim nga Palët. Këto ndryshime mund të hyjnë në fuqi në pajtim me modalitetet e parashikuara në paragrafin 15.1.
- 15.5 Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët ose në mënyrë të njëanshme. Njoftimi i zgjidhjes hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas marrjes së njoftimit me shkrim. Njoftimi i zgjidhjes nuk ka ndikim mbi të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me informacionin e shkëmbyer në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

NË DËSHMI TË KËSAJ, përfaqësuesit e të dy Palëve, duke qenë rregullisht të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje dhe e kanë vulosur atë.

Nënshkruar në Tiranë, më 3 maj 2011 në dy kopje në gjuhët shqipe dhe frënge, ku të dy versionet janë autentikë.

**Për Qeverinë e
Republikës së Francës**



**Maryse DAVIET
Ambasador i Francës**

**Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë**



**Shyqyri DEKAVELLI
Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit
Të Informacionit të Klasifikuar**

[FRENCH TEXT – TEXTE FRANÇAIS]

Accord entre

le Gouvernement de la République française

et

le Conseil des Ministres de la République d'Albanie

**relatif à l'échange et à la protection réciproque
d'informations classifiées**

Le Gouvernement de la République française,

Le Conseil des Ministres de la République d'Albanie,

ci-après dénommés « les Parties »,

Désireux de garantir la protection des informations et matériels classifiés échangés entre les deux Etats ou des organismes publics ou privés régis par leurs lois et règlements nationaux respectifs, ou produits par eux,

Sont convenus des dispositions suivantes :

ARTICLE 1^{er}

Définitions

Aux fins du présent Accord :

- 1.1 L'expression « **informations classifiées** » désigne les informations, documents et matériels, quels qu'en soient la forme, la nature ou le mode de transmission, qu'ils soient élaborés ou en cours d'élaboration, auxquels un degré de classification ou un niveau de sensibilité a été attribué et qui, dans l'intérêt de la sécurité nationale et conformément aux lois et règlements nationaux des Parties, nécessitent une protection contre toute violation, toute destruction, tout détournement, toute divulgation, toute perte ou tout accès par toute personne non autorisée ou tout autre type de compromission.
- 1.2 L'expression « **autorité nationale de sécurité** » (ANS) désigne l'autorité nationale responsable du contrôle général et de l'application du présent Accord pour chacune des Parties.
- 1.3 L'expression « **autorités de sécurité compétentes** » (ASC) désigne toute autorité de sécurité désignée (ASD) ou toute autre entité compétente autorisée conformément aux lois et règlements nationaux des Parties, qui est responsable de l'application du présent Accord selon les domaines concernés.
- 1.4 L'expression « **contrat classifié** » désigne un contrat, un contrat de sous-traitance ou un projet dont l'élaboration et l'exécution nécessitent l'accès à des informations classifiées ou l'utilisation et la production d'informations classifiées.

- 1.5. L'expression « **partie contractante** » désigne toute personne physique ou morale ayant la capacité juridique de négocier et de conclure des contrats classifiés.
- 1.6 L'expression « **Partie d'origine** » désigne la Partie, et notamment tout organisme public ou privé régi par ses lois et règlements nationaux, qui génère ou fournit des informations classifiées à l'autre Partie.
- 1.7 L'expression « **Partie destinataire** » désigne la Partie, et notamment tout organisme public ou privé régi par ses lois et règlements nationaux, à laquelle/auquel les informations classifiées sont transmises.
- 1.8 L'expression « **tierce partie** » désigne tout Etat, y compris les personnes physiques ou morales placées sous sa juridiction, ou organisation internationale non partie au présent Accord.
- 1.9 L'expression « **Partie d'accueil** » désigne la Partie sur le territoire de laquelle une visite a lieu.
- 1.10 L'expression « **besoin d'en connaître** » désigne la nécessité d'avoir accès à des informations classifiées dans le cadre d'une fonction officielle et en vue d'exécuter une tâche spécifique.

ARTICLE 2

Champ d'application.

Le présent Accord définit le règlement commun de sécurité applicable à tout échange d'informations classifiées entre les Parties ou entre leurs organismes publics ou privés régis par leurs lois et règlements nationaux.

ARTICLE 3

Autorités nationales de sécurité

L'Autorité nationale de sécurité pour chacune des Parties est :

Pour la République française

Secrétariat général de la défense et de la sécurité nationale (S.G.D.S.N.)
51, boulevard de La Tour-Maubourg
75700 PARIS 07 SP

Pour la République d'Albanie

Direction de la Sécurité des Informations Classifiées
Conseil des Ministres
Boulevard "Dëshmorët e Kombit"
Nr.1,1000
TIRANA

Les Parties se tiennent mutuellement informées de tout changement concernant leur autorité nationale de sécurité, ainsi que leurs autorités de sécurité compétentes.

ARTICLE 4

Principes de sécurité

- 4.1 Conformément à leurs lois et règlements nationaux respectifs, les Parties prennent les mesures propres à assurer la protection des informations classifiées transmises, reçues ou générées en vertu des dispositions du présent Accord et leur accordent un niveau de protection équivalent à celui appliqué à leurs propres informations classifiées nationales, tel que défini au paragraphe 1 de l'article 5.
- 4.2 La Partie destinataire appose sa propre classification nationale aux informations classifiées en provenance de la Partie d'origine, conformément aux équivalences définies au paragraphe 1 de l'article 5.
- 4.3 L'accès aux informations classifiées est strictement réservé aux ressortissants des Parties qui ont obtenu l'habilitation appropriée et dont les fonctions rendent l'accès à ces informations essentiel, sur la base du besoin d'en connaître.
- 4.4 La Partie destinataire ne déclassifie ni ne déclassifie des informations classifiées transmises sans le consentement écrit préalable de la Partie d'origine.
- 4.5 Les Parties se tiennent mutuellement informées et sans délai de tout changement affectant la protection des informations classifiées échangées ou produites en vertu du présent Accord.
- 4.6 Les informations classifiées transmises ne peuvent être utilisées à des fins autres que celles auxquelles elles ont été transmises.
- 4.7 Les Parties s'assurent que toute condition issue de leurs lois et règlements nationaux relatifs à la sécurité, concernant la sécurité d'agences, de bureaux et d'établissements relevant de leur compétence, sont respectées, notamment par le biais d'inspections.

ARTICLE 5

Niveaux de classification de sécurité et équivalences

- 5.1 Les Parties s'engagent à assurer la protection des informations classifiées échangées et adoptent les équivalences de niveaux de classification de sécurité définies dans le tableau ci-dessous

FRANCE	ALBANIE
TRES SECRET DEFENSE	TEPËR SEKRET
SECRET DEFENSE	SEKRET
CONFIDENTIEL DEFENSE	KONFIDENCIAL
(voir ci-dessous paragraphes 2 et 3 de l'article 5)	I KUFIZUAR

- 5.2 La République française traite et protège les informations portant la mention « I KUFIZUAR », transmises par la République d'Albanie, conformément à ses lois et règlements nationaux en vigueur relatifs aux informations protégées mais non classifiées portant une mention telle que « DIFFUSION RESTREINTE »
- 5.3 La République d'Albanie traite et protège les informations non classifiées portant une mention indiquant qu'elles sont protégées telle que « DIFFUSION RESTREINTE » transmises par la République française conformément à ses lois et règlements nationaux en vigueur relatifs à la protection des informations portant la mention « I KUFIZUAR ».
- 5.4 Les ANS ou les ASC s'informent mutuellement de toute nouvelle classification de sécurité ou de toute modification de classification concernant toute information qui pourrait être échangée ou produite en vertu du présent Accord.
- 5.5 Pour des raisons de sécurité particulières, lorsque la Partie d'origine exige que l'accès à des informations classifiées soit limité aux personnes ayant exclusivement la nationalité des Parties, ces informations portent une mention supplémentaire telle que « SPECIAL FRANCE – ALBANIA ».
- 5.6 Afin de maintenir des normes de sécurité comparables, chaque Partie fournit, à la demande de l'autre, toutes les informations requises relatives aux lois, règlements et procédures de sécurité nationales appliqués pour assurer la sécurité des informations classifiées. Les Parties conviennent de faciliter les contacts entre leurs ANS et leurs ASC respectives.

ARTICLE 6

Procédure d'habilitation de sécurité

- 6.1 En vue de l'accès aux informations classifiées au niveau CONFIDENTIEL DEFENSE / KONFIDENCIAL ou à un niveau plus élevé, chaque Partie applique une procédure d'habilitation de sécurité conformément à ses lois et règlements nationaux.
- 6.2 En vue de l'habilitation de sécurité d'un ressortissant de l'une des Parties qui a séjourné ou se trouve encore sur le territoire de l'autre Partie, l'ANS ou les ASC de chacune des Parties se prêtent mutuellement assistance conformément à leurs lois et règlements nationaux.

- 6.3 Les Parties reconnaissent mutuellement les habilitations de sécurité délivrées à leurs ressortissants dans le cadre de l'accès à des informations classifiées.
- 6.4 Si l'ANS ou les ASC de l'une des Parties considère(nt) qu'une société immatriculée sur le territoire national de ladite Partie est la propriété ou est sous le contrôle d'un Etat tiers dont les fins ne sont pas compatibles avec les intérêts de cette Partie, la société en question ne se voit pas délivrer d'habilitation de sécurité. Les ANS ou les ASC des Parties ayant sollicité une habilitation de sécurité des établissements doivent être informées en conséquence dans les plus brefs délais.
- 6.5 Les ANS ou les ASC se tiennent mutuellement informées des changements qui affectent les habilitations de sécurité de leurs ressortissants relevant du présent Accord, en particulier en cas de retrait ou de déclassement d'une habilitation.

ARTICLE 7

Utilisation des informations classifiées

- 7.1 La Partie destinataire ne peut divulguer les informations classifiées échangées ou élaborées en vertu du présent Accord à une tierce partie sans le consentement écrit préalable de l'ANS ou des ASC de la Partie d'origine.
- 7.2 Les informations classifiées élaborées conjointement par les Parties en vertu d'accords, de contrats ou dans le cadre de toute activité commune ne sauraient être déclassées, déclassifiées ou transférées à une tierce partie sans le consentement écrit préalable de l'autre Partie.
- 7.3 Avant de transmettre aux parties contractantes des informations classifiées reçues de la Partie d'origine, l'ANS ou les ASC de la Partie destinataire doivent :
- a) s'assurer que les parties contractantes et leurs établissements sont en mesure de protéger comme il convient les informations classifiées
 - b) accorder le niveau d'habilitation requis aux établissements de la partie contractante considérée ;
 - c) accorder le niveau d'habilitation requis aux personnes concernées conformément au principe du « besoin d'en connaître »
 - d) s'assurer que toutes les personnes qui ont accès à des informations classifiées ont été informées de leurs devoirs et de leurs responsabilités résultant des lois et règlements nationaux applicables ;
 - e) procéder à des contrôles de sécurité des établissements appropriés,

ARTICLE 8

Traduction, reproduction et destruction

- 8.1 La Partie destinataire procède au marquage des reproductions et des traductions élaborées de manière identique aux originaux et leur accorde la même protection.

- 8.2 Les informations classifiées TRES SECRET DEFENSE / TEPËR SEKRET ne sont ni reproduites ni traduites. Des documents originaux et des traductions supplémentaires peuvent être fournis sur demande écrite à la Partie d'origine.
- 8.3 Les informations classifiées TRES SECRET DEFENSE / TEPËR SEKRET ne doivent pas être détruites, sauf autorisation expresse de la Partie d'origine. Elles sont restituées à la Partie d'origine conformément aux dispositions des paragraphes 1 et 2 de l'article 9 ci-dessous, lorsqu'il a été reconnu qu'elles ne sont plus nécessaires ou après la venue à expiration de leur validité.
- 8.4 La traduction et la reproduction d'informations classifiées SECRET DEFENSE / SEKRET sont autorisées uniquement avec le consentement écrit de l'ANS ou des ASC de la Partie d'origine.
- 8.5 Les informations classifiées sont détruites de telle manière que leur reconstruction totale ou partielle soit impossible.
- 8.6 En cas de situation de crise rendant impossibles la protection et la restitution d'informations classifiées générées ou communiquées en vertu du présent Accord, les informations classifiées sont détruites immédiatement. L'ANS de la Partie destinataire informe l'ANS de la Partie d'origine de la destruction des informations classifiées dans les meilleurs délais.

ARTICLE 9

Transmission d'informations entre les Parties

- 9.1 Les informations classifiées sont transmises par une Partie à l'autre Partie par la voie diplomatique, conformément aux lois et règlements nationaux de la Partie d'origine.
- 9.2 Les ANS ou les ASC peuvent, d'un commun accord, convenir de la transmission des informations classifiées par un autre moyen que la voie diplomatique, dans la mesure où ce mode de transmission se révélerait inadapté ou difficile.
- 9.3 La transmission doit satisfaire aux conditions suivantes :
- a) Le courrier est habilité à un niveau suffisant. Il est employé en permanence par la société expéditrice ou destinataire ou par l'administration et est habilité à un niveau au moins égal à celui des informations classifiées à transmettre
 - b) Le courrier détient une lettre de courrier délivrée par l'ANS ou l'ASC de l'expéditeur ou du destinataire ;
 - c) La Partie d'origine tient un registre des informations classifiées transmises et en fournit sur demande un extrait à la Partie destinataire ;
 - d) Les informations classifiées sont emballées et scellées conformément aux lois et règlements nationaux de la Partie d'origine ;
 - e) La réception d'informations classifiées est confirmée par écrit dans les meilleurs délais.

- 9.4 La transmission d'une quantité importante d'informations classifiées est organisée, entre les ANS ou les ASC respectives au cas par cas.
- 9.5 La transmission électronique d'informations classifiées s'effectue sous forme cryptée au moyen des méthodes et dispositifs cryptographiques approuvés d'un commun accord par les ANS ou les ASC respectives.

ARTICLE 10

Contrats classifiés

- 10.1 L'ANS ou les ASC de la Partie d'origine informent l'ANS ou les ASC de la Partie destinataire de tout contrat classifié avant tout échange d'informations classifiées. Cette notification doit préciser le niveau de classification le plus élevé des informations mises en œuvre dans le contrat.
- 10.2 La Partie qui souhaite conclure, ou autoriser l'une de ses parties contractantes à conclure un contrat classifié avec une partie contractante de l'autre Partie s'assure auprès de l'ANS ou des ASC de cette Partie que ladite partie contractante est habilitée au niveau requis en vue d'exécuter le contrat. À défaut d'une telle habilitation, l'ANS ou les ASC de la Partie destinataire engagent une procédure d'habilitation au niveau requis.
- 10.3 Avant de conclure un contrat classifié avec une partie contractante relevant de la juridiction de l'autre Partie ou d'autoriser l'une de ses propres parties contractantes à conclure un contrat classifié sur le territoire de l'autre Partie, la Partie concernée doit avoir reçu de l'ANS ou des ASC de l'autre Partie l'assurance écrite que la partie contractante envisagée est habilitée à un niveau suffisant et a pris toutes les mesures de sécurité requises afin d'assurer la protection des informations classifiées.
- 10.4 Tout contrat classifié doit comprendre une annexe de sécurité. Dans cette annexe, l'ANS ou les ASC de la Partie d'origine précisent les éléments nécessitant une protection de la part de la Partie destinataire, ainsi que le niveau de classification qu'il convient d'appliquer. Seule la Partie d'origine est en mesure de modifier le niveau de classification défini dans l'annexe de sécurité.
- 10.5 Tout contrat classifié contient des informations relatives aux instructions de sécurité ainsi qu'un guide de classification. Ces instructions sont conformes, à celles dispensées par l'ANS ou les ASC de la Partie d'origine.
- 10.6 L'ANS ou les ASC de la Partie d'origine transmettent une copie de l'annexe de sécurité à l'ANS ou aux ASC de l'autre Partie.
- 10.7 Les ANS ou les ASC des Parties sur le territoire desquelles le travail doit être réalisé doivent faire en sorte que soit appliqué et maintenu, dans le cadre de l'exécution des contrats classifiés, un niveau de sécurité équivalent au niveau requis pour assurer la protection de leurs propres contrats classifiés.

- 10.8 Avant de signer un contrat classifié avec une partie sous-traitante, la partie contractante reçoit l'autorisation de son ANS ou de ses ASC. Les parties sous-traitantes se conforment aux mêmes conditions de sécurité que celles fixées pour la partie contractante.

ARTICLE 11

Visites

- 11.1 Les visites des établissements de l'une des Parties qui impliquent l'accès d'un représentant de l'autre Partie à des informations classifiées, ou les visites de sites dans le cadre desquelles un accès direct à ce type d'informations est possible, sont soumises à l'autorisation écrite préalable de l'ANS ou des ASC de la Partie d'accueil.
- 11.2 Les visites des établissements de l'une des Parties par une tierce partie qui impliquent l'accès à des informations classifiées échangées entre les Parties ou produites par celles-ci, ou les visites de sites dans le cadre desquelles un accès direct à ce type d'informations est possible, sont soumises à l'autorisation écrite préalable de l'ANS ou des ASC de l'autre Partie.
- 11.3 Les visites mentionnées aux paragraphes 1 et 2 ci-dessus nécessitent que tous les visiteurs justifient d'un niveau d'habilitation approprié et du besoin d'en connaître.
- 11.4 Les demandes de visites nécessitant un accès à des informations classifiées de niveau TRES SECRET DEFENSE / TEPER SEKRET sont transmises par la voie diplomatique à l'ANS de la Partie d'accueil. Les demandes de visites nécessitant l'accès à des informations classifiées de niveau inférieur sont traitées directement entre les ANS ou les ASC respectives des Parties. Les demandes sont adressées au moins trois (3) semaines avant la date de visite requise.
- 11.5 Toute demande de visite doit comporter les renseignements suivants :
- a) le prénom, le nom, la date et le lieu de naissance, la nationalité et le numéro du passeport ou de la carte d'identité du visiteur ;
 - b) l'emploi et la fonction du visiteur et le nom de l'organisme ou de l'institution qui l'emploie ;
 - c) le niveau d'habilitation de sécurité du visiteur, authentifié par un certificat de sécurité fourni par l'ANS ou l'ASC de la Partie requérante ;
 - d) la date envisagée pour la visite et sa durée prévue ;
 - e) l'objet de la visite et tous renseignements nécessaires précisant les sujets à traiter mettant en jeu des informations classifiées et le niveau de classification de celles-ci ;
 - f) les noms des organismes, des établissements et des locaux qui font l'objet de la visite ;
 - g) les nom et prénom des personnes qui doivent accueillir le visiteur ;
 - h) la date, la signature et le timbre officiel de l'ANS ou de l'ASC de la Partie requérante.

- 11.6 Chaque Partie peut demander une autorisation de visite pour une durée maximale de douze (12) mois. Si une visite ne peut être effectuée dans les délais prévus par l'autorisation de visite, ou si une prorogation de la durée prévue par l'autorisation de visite est nécessaire, la Partie requérante peut demander une nouvelle autorisation de visite, sous réserve que cette demande soit présentée au moins trois (3) semaines avant l'expiration de l'autorisation en cours.
- 11.7 Tous les visiteurs doivent se conformer aux règlements de sécurité et aux instructions de la Partie d'accueil.
- 11.8 Les Parties peuvent établir une liste des personnels autorisés à effectuer plusieurs visites en rapport avec tout projet, programme ou contrat spécifique conformément aux modalités habituelles convenues par les ANS ou les ASC des Parties. Ces listes sont initialement valables pour une durée de douze (12) mois ; cette durée de validité peut, par accord entre les ANS ou les ASC des Parties, être prorogée pour des périodes supplémentaires n'excédant pas douze (12) mois au total.
- 11.9 Les listes mentionnées au paragraphe 11.8 ci-dessus sont arrêtées conformément aux lois et règlements nationaux de la Partie d'accueil. Une fois ces listes approuvées, les modalités habituelles de toute visite spéciale peuvent être définies directement par les organismes que les personnes mentionnées sur ces listes doivent visiter.

ARTICLE 12

Atteintes à la sécurité

- 12.1 Dans le cas où une infraction aux règlements nationaux relatifs à la protection des informations classifiées transmises en vertu du présent Accord ne peut être écartée ou lorsqu'elle est présumée ou découverte, notamment en cas de perte ou de tout autre type de compromission malhonnête avérée ou suspectée, l'ANS ou les ASC de l'autre Partie en sont informées sans délai et par écrit.
- 12.2 La notification doit être suffisamment détaillée pour que la Partie d'origine puisse pleinement évaluer les conséquences.
- 12.3 La Partie qui a découvert ou suspecté les faits diligente aussitôt une enquête (avec, si nécessaire, l'aide de l'autre Partie), conformément aux lois et règlements nationaux applicables de l'Etat concerné. La Partie menant l'enquête informe dans les meilleurs délais l'ANS ou les ASC de l'autre Partie des résultats de l'enquête, des mesures décidées et des actions correctrices engagées.

ARTICLE 13

Frais

- 13.1 L'application du présent Accord ne génère pas en principe de frais particuliers.

- 13.2** Les frais encourus par une Partie dans le cadre de la mise en œuvre du présent Accord sont pris en charge par cette Partie uniquement.

ARTICLE 14

Règlement des différends

- 14.1 Tout différend relatif à l'interprétation ou à l'application du présent Accord est réglé exclusivement par voie de consultations entre les Parties, en excluant tout recours à une tierce partie ou à une juridiction internationale.
- 14.2 Pendant la durée du différend, les Parties s'engagent à respecter les obligations énoncées dans le présent Accord.

ARTICLE 15

Dispositions finales

- 15.1 Le présent Accord est conclu pour une durée indéterminée. Chacune des Parties notifie à l'autre Partie l'accomplissement des procédures internes requises en ce qui la concerne pour l'entrée en vigueur du présent Accord. Le présent Accord prend effet le premier jour du deuxième mois suivant la réception de la dernière des notifications.
- 15.2 Les ANS ou les ASC des Parties se consultent en tant que de besoin au sujet des aspects techniques spécifiques relatifs à l'application du présent Accord et peuvent conclure, au cas par cas, tout instrument juridique ou protocole de sécurité spécifique approprié complétant le présent Accord.
- 15.3 Chaque Partie informe sans délai l'autre Partie de toute modification de ses lois et règlements nationaux susceptible d'avoir un effet sur la protection des informations classifiées en vertu du présent Accord. Dans ce cas, les Parties se consultent afin d'étudier les modifications éventuelles à apporter au présent Accord. Dans l'intervalle, les informations classifiées continuent d'être protégées conformément aux présentes dispositions.
- 15.4 Les dispositions du présent Accord peuvent être modifiées par accord écrit entre les Parties. Les modifications prennent effet selon les modalités prévues au paragraphe 1 ci-dessus.
- 15.5 Le présent Accord peut être dénoncé soit d'un commun accord soit unilatéralement. La dénonciation prend effet six (6) mois après réception de la notification par écrit. La notification de dénonciation n'a aucun effet sur les droits et obligations des Parties relatifs aux informations échangées en vertu du présent Accord.

EN FOI DE QUOI, les représentants des deux Parties dûment autorisés à cet effet ont signé le présent Accord et y ont apposé leur sceau.


Signé à Tirana, le 3 mai 2011, en deux exemplaires originaux, en langues française et albanaise, les deux versions faisant également foi.

**Pour le Gouvernement de
la République française**



Maryse DAVIET
Ambassadeur de France en Albanie

**Pour le Conseil des Ministres
de la République d'Albanie**



Shyqyri DEKAVELLI
Directeur pour la sécurité
des informations classifiées